



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AVOKATI I POPULLIT
Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës,
trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/319
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. K4/I13-2 Prot.
Nr. Dok. 202502298/2

Tiranë 27 /08 /2025

Lënda: *Rekomandohet përmirësimi i kushteve dhe i trajtimit të të paraburgosurve/dënuarve në I.E.V.P. "Mine Peza" 302 në Tiranë.*

Drejtuar: **Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve**

TIRANË

Z. Kolë KUKAJ
Drejtore në I.E.V.P. 302 "Mine Peza"

TIRANË

Për dijeni: **Z. Ulsi MANJA**
Ministër i Drejtësisë

TIRANË

Të nderuar,

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin e deritanishëm midis institucioneve tona, si dhe duke vlerësuar angazhimin për punën e stafit të institucionit që ju drejtoni, në vijim po ju njohim me gjetjet dhe rekomandimet nga monitorimi që institucioni i Avokatit të Popullit zhvilloi në I.E.V.P. "Mine Peza" 302 Tiranë.

Inspektimi në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale (IEVP) "Mine Peza" 302 Tiranë u zhvillua nga Mekanizmi Kombëtar për parandalimin e torturës, trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues, në vijim Mekanizmi Kombëtar (MKPT), seksion pranë Avokatit të Popullit, bazuar në nenin 19/1 të ligjit nr.8454, datë 04.02.1999, "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar dhe nenin 81 të ligjit nr.81/2020 "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve".

Inspektimi u krye në datë 20.02.2025, sipas Planit të Inspektimit të miratuar nga Avokati i Popullit. Në përbërje të grupit inspektues ishin znj. Nertila Qafzezi, znj. Gloria Çarkaxhiu dhe znj. Lindita Dedegjoni me detyrë nd/komisionere pranë Mekanizmit Kombëtar.

Qëllimi i vizitës inspektuese ishte vlerësimi i përgjithshëm i respektimit të të drejtave të të burgosurve, të cilat u garantohen me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, aktet ligjore dhe me standardet ndërkombëtare për të drejtat themelore të tyre. U inspektuan ambientet në regjimin e brendshëm të institucionit, në lidhje me plotësimin e kushteve materiale dhe infrastrukturore për jetesë dhe zhvillimin e aktiviteteve për të burgosurit, si dhe u verifikua zbatimi i rekomandimeve të Avokatit të Popullit në inspektimin e mëparshëm.

Vizita inspektuese ishte e pa lajmëruar dhe pa mbikëqyrjen e stafit të institucionit gjatë zhvillimit të intervistave me të paraburgosurit. Grupit të monitorimit ju krijuan kushte pune nëpërmjet një bashkëpunimi të frytshëm me drejtuesit dhe stafin e institucionit, me qëllim arritjen e objektivave të inspektimit dhe në përputhje me metodologjinë e inspektimit në burgje.

Ekspertët e MKPT-së, patën akses të plotë për të inspektuar ambientet e banimit të të burgosurve, vendet e ajrimit, dhomat e observimit dhe të veçimit, klasat e edukimit, kuzhinën, lavanderinë etj, si dhe bënë këqyrjen e dokumentacionit që administrohej nga secili prej sektorëve të institucionit. U zhvilluan gjithashtu edhe intervista konfidenciale me të paraburgosurit, në përputhje me Rregulloren e Përgjithshme të Burgjeve.

Institucioni i Avokatit të Popullit, pasi u njoh me konstatimet e grupit të inspektimit, ka detyrimin ligjor t'ju parashtojë gjetjet e këtij inspektimi, si më poshtë vijon:

Shënime paraprake

Kjo ishte vizita periodike monitoruese e Avokatit të Popullit në I.E.V.P. “Mine Peza” 302, për vitin 2025. Gjatë takimit me drejtorin z. Kolë Kukaj, grupi inspektues kërkoi fillimisht informacion në lidhje me të drejtat dhe trajtimin e të paraburgosurve, mënyrën e trajtimit nga ana e institucionit të problematikave të ndeshura në inspektimin e mëparshëm, si dhe verifikimin e nivelit të zbatimit të rekomandimeve të bëra nga institucioni i Avokatit të Popullit një vit më parë¹. Me urdhër të Ministrit të Drejtësisë nr. 8927/1, datë 27.09.2018, “*Për kategorizimin e institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale*” I.E.V.P. Mine Peza kategorizohet “Institucion Paraburgimi”.

Ky institucion ka një kapacitet maksimal prej 166 personash, referuar Urdhrit të Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve Nr.735 Prot, datë 04.05.2023 “*Për Miratimin e kapaciteteve të Institucioneve të Ekzekutimeve të Vendimeve Penale*”. Në ditën e

¹ Rekomandim Nr.K4/I14-2 Prot, Dt. 28.06.2024, Rekomandohet përmirësimi i kushteve dhe i trajtimit të të paraburgosurve/dënuarve në I.E.V.P. “Mine Peza”302 në Tiranë.

inspektimit, në mjediset e institucionit ishin 164 persona dhe 4 të paraburgosur në spital në total 168 të paraburgosur. Të dhënat për numrin e të paraburgosurve për periudhën Shtator 2024 – Janar 2025 vijnë si më poshtë:

1. **Shtator 2024** të paraburgosur 163
2. **Tetor 2024** të paraburgosur 163
3. **Nëntor 2024** të paraburgosur 163
4. **Dhjetor 2024** të paraburgosur 171
5. **Janar 2025** të paraburgosur 158
6. **Shkurt 2025** të paraburgosur 168

Sa më sipër rezulton se nuk ka mbipopullim referuar kapacitetit zyrtar të miratuar, mesatarja e të paraburgosurve paraqitet në 164 persona, por lidhur me këtë çështje Avokati i Popullit vlerëson se rritja e numrit të shtretërve në institucion rrit gradualisht numrin e të burgosurve në dhomat e banimit e për pasojë cenon hapësirën jetike të parashikuar në legjislacionin e brendshëm dhe standardet ndërkombëtare.

Mbipopullimi në dhoma nisur nga standardet kombëtare për respektimin e hapësirës jetike për person, ishte prezent pothuajse në të gjitha dhomat e vuajtjes të dënimit. Të njëjtat qëndrime të Avokatit të Popullit janë theksuar dhe nga CPT² e cila kërkon konfirmim se norma e akomodimit në qeli, në burgun “Mine Peza” 302 është ulur, për të siguruar së paku 4m² hapësirë jetese për person në pjesën më të madhe të qelive (pa përfshirë hapësirën e tualetit). Pjesa më e madhe e 11 qelive në katin e parë të godinës ishin më pak se 3m² sipërfaqe për person. Sa më sipër demonstroi qartë se kapacitetet e institucionit nuk respektojnë hapësirën jetike për person si dhe kushtet minimale të jetesës. Për këtë Avokati i Popullit vlerëson se duhet të ndryshojë kapaciteti i akomodimit në këtë institucion për ta sjellë në përputhje me standardet.

Nga inspektimi u konstatua se, një pjesë e të paraburgosurve që ishin të vendosur në dhoma mbi kapacitet. Këto dhoma ishin pajisur me shtretër për fjetje dhe të vendosur në dhoma të destinuara për 2 persona në to gjendeshin 4 persona.

Nga inspektimi i ambienteve do të veçonim dhomën nr.1 kati i tretë e cila ka 8 persona në dhomë 1 ndër të cilët ndodhej në QSB, duke ngushtuar në këtë mënyrë hapësirat e dhomave ekzistuese gjithashtu kushtet e këqija të jetesës mungesa e ajrit, kushtet jo të mira të higjienës dhe stresi i shtuar mund të kenë ndikime negative në shëndetin mendor dhe fizik të të ndaluarve, si dhe të krijojnë mundësi për shpërthime të sëmundjeve infektive.

CPT rekomandon që autoritetet shqiptare të dyfishojnë përpjekjet e tyre për të luftuar mbipopullimin e burgjeve, duke marrë parasysh rekomandimet përkatëse të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës³.

² Komiteti Evropian për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimi ose Ndëshkimi Çnjerëzor ose Degradues, <https://www.coe.int/en/web/cpt>.

³ Në veçanti, Rekomandimet R(99)22 në lidhje me mbipopullimin e burgjeve dhe inflacionin e popullsisë së burgjeve, Rec(2003)22 për lirimin me kusht (lirimin me kusht), Rec(2006)13 për përdorimin e paraburgimit, kushtet në të cilat duhet të bëhen dhe sigurimi i masave mbrojtëse kundër abuzimit,

Në ditën e inspektimit të paraburgosur me probleme shëndetësore ishin: 35 persona të sëmurë kronikë, 13 persona të sëmurë me probleme të shëndetit mendor, 7 persona me diabet dhe 4 persona përdorues të lëndëve narkotike që trajtohen me metadon.

Të paraburgosur të punësuar në institucion ishin 10 persona, të cilët punonin sipas pozicioneve: ndihmës kuzhinier, shpërndarës ushqimi, ndihmës kuzhinier, punëtor lavanterie, mirëmbajtës, magazinier, sanitar, berber, bojaxhi, murator.

Struktura e miratuar me Urdhër të Kryeministrit nr.68 dat 30.04.2024 për miratimin e strukturës dhe të organikës së Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe sistemit të institucioneve në varësi të saj, e ndryshuar me urdhrin nr.13 datë 30.01.2025 “ Për disa ndryshime në urdhrin nr.68, datë 30.04.2024, të Kryeministrit”. Struktura e miratuar është prej 123 punonjësish në total, ndërkohë në institucion aktualisht ishin 117 punonjës ndër të cilët:

Numri i Punonjësve civil: Organika e miratuar është 35 ndërkohë faktike ishin 32 punonjës, në mungesë 3 punonjës saktësisht 1 teknik i mesëm i specialiteteve të ndryshme, 1 kuzhinier, 1 shofer.

Aktualisht organika e I.E.V.P.-së, Mine Peza me staf policor, ishte 88 punonjës ndër to 3 në mungesë.

Spektori shëndetësor 1 një mjek i përgjithshëm, 5 ndihmës mjekë, 1 një stomatolog dhe 1 farmacist. Nuk kishte vakanca.

Spektori psiko - social 1 një psikologe e cila është përgjegjëse për çështjet shoqërore, 3 specialiste edukimi. Nuk kishte vakanca.

Nisur nga problematikat e konstatuara gjatë kësaj vizite monitoruese, informacionet e marra nga drejtori dhe stafi i institucionit, si dhe intervistave konfidenciale të zhvilluara me personat e privuar nga liria rezultoi se, nga rekomandimet e institucionit të Avokatit të Popullit si dhe nga inspektimi i mëparshëm, drejtuar institucionit ishin realizuar si më poshtë:

1. Ishin marrë masat për rishikimin e menysë ditore të ushqimit veçanërisht për vaktin ushqimor të darkës.
2. Ishin marrë masat për riparimin e mbulesës së bokseve të ajrimit, për të ndaluar futjen e ujit në kohë me shi.
3. Ishin marrë masat pjesërisht për lyerjen dhe dezinfektimin e dhomave të banimit të paraburgosurve.

4. Ishin marrë masa pjesërisht për rritjen e numrit të aktiviteteve, me qëllim që të paraburgosurit, të kenë aktivitete të shumta edukative, sportive dhe të mundësohet që të zhvillojnë edhe aktivitete tjera, me të cilat shprehin talentin në punën dhe zanatet e tyre që ata zotërojnë.
5. Ishin marrë masat për organizimin e vizitave frekvente 1 herë në 2 javë të një psikiatri në këtë I.E.V.P për të sëmurët e shëndetit mendor.

Ndërkohë që një pjesë e rekomandimeve të paraqitura nga Avokati i Popullit të një viti më parë nuk kishin gjetur zbatim konkretisht,

1. Nuk ishin marrë masa për rishpërndarjen e të paraburgosurve të cilët të jenë të sistemuar në dhoma bazuar në kapacitetet e institucionit.
2. Nuk ishin marrë masa për eliminimin e lagështisë e cila është e pranishme kudo në regjimin e brendshëm, në kushte emergjente për tu riparuar.
3. Nuk ishin marrë masa për pajisjen me sistem ajrimi të ambienteve të përbashkëta të vuajtjes së dënimit, korridoret janë pa dritare dhe ka mungesë ajrimi.
4. Nuk ishin marrë masa për ruajtjen e higjienës dhe kushteve higjieno sanitare në ambientet e brendshme të banimit të paraburgosurve.
5. Nuk ishin marrë masa për të zhvilluar kurse profesionale në favor të personave të paraburgosur në I.E.V.P, “Mine Peza” 302 Tiranë.
6. Nuk ishin marrë masa për pajisjen e Institucionit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale (I.E.V.P), “Mine Peza” 302 Tiranë me ambulancë për të shoqëruar personat në spitalet përkatëse të vendit në përputhje me nevojat shëndetësore të të paraburgosurve
7. Nuk ishin marrë masa për rishikimin e rregullores së brendshme të institucionit për shtimin e normativave mujore për të paraburgosurit me qëllim mbajtjen e higjienës personale, mirëmbajtjen dhe pastërtinë në dhomat e banimit dhe ambientet e përbashkëta, si dhe shmangien e abuzimeve nga punonjësit e institucionit në shpërndarjen e tyre.
8. Nuk ishin marrë masa për pajisjen e dhomave të paraburgosurve me dollapë për të mbajtur sendet personale dhe ushqimet.
9. Nuk ishin marrë masa për rishikimin e kapaciteteve të I.E.V.P. “Mine Peza” (302) duke respektuar standardet e parashikuara në nenin 33 të ligjit nr. 81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, për hapësirën jetike për çdo të burgosur.

Ndërkohë problematika të rëndësishme që u konstatuan sërish janë:

Kushtet infrastrukturore.

Lagështia është e pranishme kudo, në kushte emergjente për tu riparuar, në I.E.V.P “Mine Peza” 302, problem shqetësues vazhdon të jetë dhe **amortizimi i rrjetit elektrik** në rregjimin e brendshëm. Pjesa më e madhe e problematikave të evidentuara më herët përgjatë inspektimeve, në këtë institucion të tilla **si ventilimi dhe ndriçimi natyral dhe drita e pamjaftueshme natyrale vazhdonin të ishin ekzistuese.**

Në përmbledhje, lagështia e theksuar në I.E.V.P. Mine Peza është një problem që kërkon vëmendje të menjëhershme dhe investime të qëndrueshme për të siguruar kushte të pranueshme dhe të shëndetshme për të paraburgosurit gjithashtu edhe për stafin.

Mbipopullimi në dhoma nisur nga standardet kombëtare për respektimin e hapësirës jetike për person, ishte prezente pothuajse në të gjitha dhomat e vuajtjes të dënimit. Të njëjtat qëndrime të Avokatit të Popullit janë theksuar dhe nga CPT⁴ e cila kërkon konfirmim se norma e akomodimit në qeli, në burgun “Mine Peza” 302 është ulur, për të siguruar së paku 4m² hapësirë jetese për person në pjesën më të madhe të qelive (pa përfshirë hapësirën e tualetit). Pjesa më e madhe e qelive ishin më pak se 3m² sipërfaqe për person. Sa më sipër demonstroi qartë se kapacitetet e institucionit nuk respektojnë hapësirën jetike për person si dhe kushtet minimale të jetesës. Nga inspektimi u konstatua se në 50 % ishte fenomeni se një pjesë e të paraburgosurve ishin të vendosur në dhoma mbi kapacitet, në dhoma të destinuara për 2 persona në to ishin vendosur 4 persona duke ngushtuar në këtë mënyrë hapësirat e dhomave ekzistuese, kjo duke shtuar numrin e shtretërve me krevate marinarë me dy kate.

Grupi i inspektimit në vijim të punës, vizitoi mjediset e regjimit të brendshëm I.E.V.P-së “Mine Peza” 302, ku këqyri regjistrat dhe dokumentacionin e disa praktikave, që kanë të bëjnë me të drejtat e të paraburgosurve, si dhe zhvilloi intervista në mënyrë konfidenciale me ta në dhomat e tyre.

Në përfundim, grupi i inspektimit administroi gjithashtu kopje të dokumentacionit, konkretisht:

- Organikën e Institucionit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale Mine Peza 302;
- librin e pritjes të paraburgosurve;
- praktikë pune të komisionit të pritjes;
- praktikë pune për dhënie mase disiplinore të paraburgosurve;
- plani i aktiviteteve të Sektorit të Kujdesit Social për periudhën janar -shkurt 2025.

4

Komiteti Evropian për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimin ose Ndëshkimit Çnjerëzor ose Degradues, <https://www.coe.int/en/web/cpt>, viti 2023.

Trajtimi

Objekti i vizitës inspektuese të grupit të monitorimit, ishte trajtimi i të paraburgosurve, identifikimi i rasteve të përdorimit të forcës fizike tej kufijve të parashikuar në aktet normative, apo presionit psikologjik ndaj tyre, si dhe përdorimi efektiv i masave disiplinore në bazë të kushteve dhe kriterëve të përcaktuara në aktet ligjore kombëtare dhe aktet ndërkombëtare të fushës.

Nga informacioni që u grumbullua gjatë vizitës inspektuese dhe intervistimi i të paraburgosurve, grupi monitorues nuk konstatoi raste apo pretendime nga të paraburgosurit, lidhur me keqtrajtim apo tejkallim të forcës fizike nga ana e punonjësve të shërbimit të sigurisë apo e stafit të institucionit dhe as morri ankesa për ndonjë çështje të tillë.

Grupi i inspektimit, i kushtoi vëmendje dhe plotësimit të kushteve materiale e të jetesës për të paraburgosurit në këtë institucion. Inspektimi u përqendrua kryesisht tek kushtet e banimit, mbipopullimi në dhoma, higjiena personale, kushtet sanitare, veshjet, cilësia e përgatitjes dhe shpërndarjes në kohë të ushqimit, ndriçimi, ventilimi, ngrohja, ambientet e takimit me familjarët, komunikimi telefonik dhe monitorimi me kamera i ambienteve të përcaktuara sipas skemës së sigurisë.

Nga inspektimi i ambienteve rezultoi se në I.E.V.P. Mine Peza 302, brenda murit rrethues janë në funksion 4(katër) godina: Godina e administratës 3(tre) katëshe; Godina e vendosjes së gjeneratorit një katëshe; Godina dy katëshe brenda Regjimit të Brendshëm (oborr), kati i parë dy ambiente për stomatologun dhe infermierinë; Godina e banimit tre katëshe për të p/burgosurit (Regjimi i brendshëm) me kapacitet për 166 të paraburgosur.

Regjimi i brendshëm

Nga inspektimi i dhomave të banimit konstatuam se nevojitet rishpërndarja e menjëhershme e të paraburgosurve në mënyrë proporcionale duke respektuar standardet minimale të hapësirës dhe duke shfrytëzuar kapacitetet e institucionit, për të shmangur mbipopullimin e krijuar nëpër dhomat e banimit.

Kati i parë përbëhet nga 11 dhoma me kapacitet banimi për 36 vende, shuma totale e shtretërve është 48 (12 shtretër të shtuar plus kapacitetit) Aktualisht në katin e Parë ndodheshin 44 të paraburgosur (duke përfshirë observim+ veçim). Ndërkohë që observimi dhe veçimi nuk llogariten në kapacitetin zyrtar.

Mjedisi i takimit me familjarët (4 bokse të ndara me zgarë hekuri, të pajisur me tavolinë druri, stola plastike e mbajtur pastër).

- Dy dhoma për takimet me avokatin të pajisura secila me orendi: 2 (dy) tavolina, karrige, dhomat kishin ndriçim artificial dhe natyral.

- Dhomë këshillimi 1(një) e pajisur me orendi, tavolinë, karrige, raft me libra, piktura të varura në mur, e mbajtur pastër dhe e lyer, me ndriçim artificial dhe natyral.
- Në katin e parë kishte 1(një) dhomë veçimi dhe 1(një) dhomë observimi të pajisura me orenditë e nevojshme por në këto ambiente kishte lagështirë të theksuar.
- Dushet e përbashkëta për të paraburgosurit/burgosurit që qëndrojnë në observim, (4 bokse për larje me një bolier, 1 tualet mjedis i shtruar me pllaka dhe i ndriçuar.
- Në katin e parë ka 11 dhoma, secila me dush brenda dhomave, bolierët janë vendosur jashtë dhomës.
- Janë të afishuara në mur norma e detergjenteve, norma e ushqimit, organika e punës, lista e artikujve që shiten në njësinë tregtare me çmimet, grafiku i ajrimit dhe dusheve.
- Ajrimi bëhet në 6 bokse, të mbuluara pjesërisht me strehë, në këto ambiente ka dhe dy kartofona për komunikimin e tyre me familjarët.
- Në dhomat banimit të paraburgosurit në mungesë të dollapëve në dhomat e banimit, i mbanin sendet personale në komodina.

Kati i dytë përbëhet nga 21 dhoma me kapacitet banimi 60 vende, numri i përgjithshëm i shtretërve është 72. Aktualisht ndodheshin 55 të paraburgosur.

Në katin e dytë dushet/bolierë janë të vendosura në çdo dhomë banimi. Të gjitha dhomat, përveç atyre të anekseve, mbyllen si me derë ashtu edhe me skare hekuri. Skara e hekurit siguron ajrosje në ditët e verës, kur dera lihet e hapur. Edhe kur të burgosurit dalin në ajrim, dyert e hekurit hapen dhe zgara mbahet e mbyllur për të qarkulluar ajrin. Në çdo kat janë të vendosua edhe dy ventilatorë.

Kati i tretë përbëhet nga 17 dhoma me kapacitet banimi për 60 persona, shuma totale e shtretërve është 72. Aktualisht ndodheshin 67 të paraburgosur.

Në këtë kat ka 17 dhoma me madhësi përafërsisht 2X5 m apo 10 m², si dhe një mjedis të përbashkët, biblioteka, dushet ishin vendosur brenda dhomave, bolierët janë vendosur jashtë dhomës.

Dhoma Nr.1 kati i tretë ka 8 persona në dhomë 1 ndër të cilët ndodhej në QSB, duke ngushtuar në këtë mënyrë hapësirat e dhomave ekzistuese duke krijuar mbipopullim. **Kjo dhomë paraqitej në kushte tejet degraduese, me një mungesë të theksuar higjienë e palyer dhe ajër të rënduar.**

Përgjatë inspektimit në I.E.V.P. 302 Mine Peza nga informacioni i marrë u evidentua se, në institucion ndodheshin të paraburgosur të grupmoshës **18-21 vjeç, të cilët nuk ishin të sistemuar në dhoma më vehte**, sikurse parashikohet në manualët e sigurisë për këtë kategori.

Kuzhina

Në IEVP Mine Peza 302 organika e miratuar ishte për 4 kuzhinierë (2 paradite, 2 mbasdite), aktualisht ishte në mungesë 1 kuzhinier.

Mjedisi i kuzhinës ishte i lyer dhe mbahej pastër. Në mur ishin afishuar: norma ushqimore, menya javore, libreza e shëndetësisë e punonjësve, lista e të sëmurëve kronik dhe lista e të sëmurëve diabetikë. Përgjatë inspektimit konstatuam se kampionët e ushqimit ishin të etiketuar sipas rregullores duke përcaktuar qartë datën dhe vaktet e ushqimit. Nga verifikimi i menysë konstatuam se ndryshe nga një vit më parë ajo ishte ndryshuar dhe ishte e larmishme.

Dhoma e mjekut

E pajisur me shtrat dhe medikamente, në mur ishte afishuar lista e medikamenteve të urgjencës (27 gjithsej).

Dhoma e stomatologut

Kabineti i stomatologut ishte i ri, i siguruar nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve.

Sistemi i monitorimit me kamera funksiononte në të gjitha ambientet.

Lavanderia ishte e pajisur me 1 (një) lavatriçe, në gjendje pune e cila shërbente vetëm për larjen e çarçafëve dhe batanijeve pasi te paraburgosurit veshmbathjet i dërgonin për larje në familje sepse kjo pajisje ishte e pamjaftueshme.

Nga informacioni i marrë konstatohet se cilësia e ujit në I.E.V.P. Mine Peza ishte e mirë dhe furnizimi me ujë nuk kishte probleme. Furnizimi me ujë kryhej përmes lidhjes me rrjetin e ujësjellësit. Grupi i inspektimit u informua se në mënyrë periodike ishin kryer analizat e ujit dhe si përfundim ishte vlerësuar se uji ishte i pijshëm në këtë institucion. Furnizimi me ujë të pijshëm është e drejtë themelore e njeriut dhe për personat e dënuar është një element parësor për trajtimin e tyre me dinjitet.

Nga komunikimi me të paraburgosurit në IEVP Mine Peza 302 rezultoi se kishte ankesa mbi:

Hapësirën e vogël të dhomave të banimit, duke patur parasysh faktin që në disa dhoma ishin të akomoduar 4 persona. Hapësirat dhe sipërfaqet e dhomave nuk i përgjigjeshin standardit për normativën që ato duhet të plotësonin për një person, ashtu siç është e sanksionuar në aktet ligjore e nënligjore dhe në aktet ndërkombëtare, për këtë qëllim.

Ankesa vinin për kushtet e ambienteve të përbashkëta të vuajtjes së dënimit, dhe veçanërisht të ambienteve të ajrimit⁵, të cilat sipas tyre ishin shumë të kufizuara dhe kjo u konstatua edhe nga grupi i inspektimit të MKPT-së.

Mungesa e hapësirave për aktivitete ishte shqetësim i vazhdueshëm pasi sipas tyre i vetmi aktivitet fizik i tyre ishte dalja në ajrim.

Si rezultat, pjesa më e madhe e të paraburgosurve ishin të detyruar të kalonin pjesën më të madhe të ditës në qelitë e tyre (shpesh të mbipopulluara), mënyra e vetme për

⁵ CPT/Inf (2019) Fq. 7 Burgu Nr. 302, kushtet mbetën të njëjta në shumë dhoma, të tilla si lagështia, ajrosja etj.

tu aktivizuar ishin lojëra në tavolinë, leximi dhe shikimi i televizorit (nëse kishte një në qeli). Sipas të paraburgosurve kjo rutinë ndryshonte nga vizitat e avokatëve, seancat gjyqësore apo vizitat familjare. Është edhe më shqetësuese që të paraburgosurit janë mbajtur në këto kushte për vite.

Avokati i Popullit thekson se duhet të përmirësohen ndjeshëm regjimi i veprimtarisë për të gjithë të burgosurit, pavarësisht nga statusi i tyre ligjor. Qëllimi duhet të jetë për të siguruar që të burgosurit të jenë në gjendje të kalojnë një pjesë të arsyeshme të ditës (d.m.th., tetë orë ose më shumë) jashtë qelisë së tyre, të angazhuar në aktivitete të qëllimshme të një natyre të ndryshme (si puna, arsimi, formimi profesional, sporti dhe rekreacioni).

Një problematikë e pretenduar nga të intervistuarit ishte edhe vonesa në kryerjen e ekzaminimeve, analizave laboratorike e konsultave në qendrat e specializuara mjekësore.

Masat mbrojtëse

Nga verifikimi dhe inspektimi i dokumentacionit lidhur me sistemin e kërkesë/ankesave rezultoi se çdo ankesë regjistrohej në regjistrin përkatës dhe protokollohej, regjistrat mbaheshin nga sekretaria e institucionit.

Të paraburgosurit plotësonin një formular kërkesë/ankese dhe ia dorëzonin më pas punonjësit të sektorit psiko-social. Punonjësi i dërgonte në sekretarinë e institucionit, ku protokolloheshin dhe pastaj i kalonin drejtorit të institucionit, i cili kthente përgjigje me shkrim apo takonte vetë të paraburgosurit.

Nga verifikimi i regjistrit të kërkesa /ankesave rezultoi se prej janarit kërkesat e të paraburgosurve ndaj institucionit ishin 36 të cilat konsistojnë në kërkimin më së shumti të lejeve shpërblyese, kërkesë për dinamikën e vuajtjes së dënimit, kërkesë për takim me avokatë, vizitat në spital, transferim, punësim ose kërkesë për blerjen e pajisjeve si TV ose frigorifer.

Bazuar në paragrafin 2, të pikës 1, të nenit 49 “Takimet, vizitat, korrespondencat dhe informacioni”, të ligjit nr. 81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve” parashikohet se “në rastin e të paraburgosurve merret miratimi paraprak me shkrim i prokurorit.”

I burgosuri ka të drejtën e vizitës të paktën katër herë në muaj nga anëtarët e familjes me kohëzgjatje të paktën 1 (një) orë. Kur organizimi i institucionit e lejon, i burgosuri mund të autorizohet të qëndrojë me familjarët përtej kufirit kohor të parashikuar. Vizitat zhvillohen në mjedise të veçanta nën mbikëqyrjen e personelit të institucionit, jo të dëgjimit, sipas rregullave të parashikuara në rregulloren e përgjithshme të burgjeve.

Ekspertët morën informacion në lidhje me pritjen e të paraburgosurve në institucion dhe funksionimin e Komisionit të Pritjes, si dhe në lidhje me plotësimin e regjistrave e dosjeve personale të tyre. Nga biseda me punonjësit e institucionit dhe verifikimeve

në dosjet përkatëse, grupi monitorues konstatoi se procedura e pranimit në institucion zbatohet në mënyrë korrekte. Nga verifikimi dhe inspektimi i dokumentacionit rezultoi se veprimet regjistroheshin në regjistrin përkatës dhe protokolloheshin.

Sistemi i monitorimit me kamera vëzhgimi ishte funksional. Institucioni ishte i pajisur tërësisht me kamera vëzhgimi. Në I.E.V.P. “Mine Peza” 302 kamerat monitoronin të gjitha mjediset për 24 orë, ndërkohë që të dhënat ruheshin në server për një periudhë 30 ditore. Cilësia e pamjeve të kamerave ishte mjaft e mirë.

Telefonat punonin në çdo kohë dhe të paraburgosurit e intervistuar, pohuan se mund të flisnin sa herë të dëshironin me të afërmit e tyre nëpërmjet telefonave me kartë që ndodheshin në mjedisin e regjimit. Grupi i inspektimit, konstatoi gjithashtu ndonëse numri telefonatave është i kufizuar (deri në 10 numra), ata deklarorin se numri i Institucionit të Avokatit të Popullit ishte i përfshirë dhe mund të komunikorin me institucionin tonë me kohë bisede pa limit dhe pa pagesë. Në Rregulloren e Përgjithshme të Burgjeve thuhet shprehimisht se: *“I burgosuri mund të komunikojë me Avokatin e Popullit në telefon, bazuar në procedurat që përshkruhen në ligjin për të drejtat dhe trajtimin e personave të dënuar me burgim dhe të paraburgosurve në çdo kohë”*⁶.

Të paraburgosur të punësuar ishin 12 persona, kryesisht si sanitarë, shpërndarës ushqimi etj. Nga takimi i grupit inspektues më të paraburgosurit që punonin brenda institucionit këta të fundit nuk kishin pretendime për kushtet e punës, dhe ndaj tyre ishin lidhur kontratat e punësimit midis të paraburgosurve të punësuar dhe institucionit, në zbatim të VKM-së nr.602, datë 13.10.2021, për shpërblimin financiar për punën e kryer.

Kushtet materiale

Grupi i monitorimit, në fokus të vizitës së tij pati edhe monitorimin e kushteve materiale, të rëndësishme për respektimin e standardeve normale të jetesës. I.E.V.P. “Mine Peza” në Tiranë është një institucion i ndërtuar në vitin 1930 dhe për këtë fakt ngelet në tërësinë e tij i amortizuar dhe me prani të lartë lagështie. Në I.E.V.P Mine Peza, shpesh ka mungesë investimesh dhe përpjekjesh për t'u përmirësuar kushtet e jetesës. Kjo bën që problemi i lagështirës dhe kushteve të tjera të vazhdojë për një kohë të gjatë, duke mos u adresuar siç duhet.

Grupi inspektues konstatoi se: në mjediset e **korridoreve të tre kateve vërehej mungesa e ajrit (duke qenë se nuk ishin dritare) çka shkaktonte një mjedis të rënduar ajrimi megjithëse në to ishin vendosur nga 2 ventilator.** Kushtet materiale ishin në përmirësim, por mbetej problematike sipërfaqja e dhomave 2X5 m apo 10 m², në të cilën qëndronin 4 të paraburgosur.

⁶ Neni 67 i Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve.

Në katin e parë të ndërtesës ndodhej sektori i dhomave të veçimit dhe dhomave të transitit të cilat ishin pajisur me batanije, çarçafë dhe karrige dhe me dollapë të vegjël për mbajtjen e sendeve personale.

Avokati i Popullit vlerëson se vendosja e personave në kushtet e një hapësire jetike prej më pak se 4m² dhe larg standardeve minimale të Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve, neni 22, pika 1, *“Në strehimin e të burgosurve mbahen parasysh kushtet dhe mundësitë konkrete të çdo I.E.V.P.-je, por në çdo rast duke iu siguruar kubatura jo më pak se 9 m³ dhe sipërfaqja e banimit jo më pak se 4 m² për çdo të burgosur, ...”*⁷ përbën trajtim degradues dhe jo human dhe shkelje të nenit 3 të KDNJ⁸.

Për sa më lart, Avokati i Popullit **kërkon ndërhyrje urgjente nga ana e Ministrisë së Drejtësisë dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve për të bërë të mundur ndryshimin e shpejtë të situatës në çdo sektor dhe garantimin e respektimit të normave të hapësirës jetike për çdo të paraburgosur.**

Konstatimet lidhur me ambientet përveç problemeve të degradimit strukturor të ndërtesës, ngrenë edhe shqetësimin e institucioneve kombëtare dhe ndërkombëtare lidhur me respektimin e të drejtave të njeriut në një vend demokratik.

Ambientet e regjimit të brendshëm kishin një mjedis për takimet me familjarët, me 4 sportele të ndara me zgarë hekurash, që monitorohej me kamera vëzhgimi dhe dy dhoma për takimin me avokatët të pajisur me pajisjet e nevojshme tavolinë e karrige.

Grupi i inspektimit konstatoi se biblioteka përdorej si një mjedis shumë-funksional, për aktivitete fetare, social-kulturore, për ditë të veçanta festash etj.

Regjimi dhe aktivitetet

Gjatë inspektimit u vu re se nuk zhvilloheshin aktivitete të përbashkëta. Në lidhje me ajrimin u konstatua se ajrimi ditor zgjaste mbi 3 (tre) orë sipas rregullores. Shumë prej të intervistuarve nëpër dhoma të pyetur për aktivitetet apo programet që ata merrnin pjesë, kërkuan të kenë aktivitete të përbashkëta sportive, dhe më shumë mjete dhe pajisje sportive.

Është për tu theksuar se një ndër qëllimet e institucioneve të mbyllura penitenciare është riintegrimi në shoqëri i personave, në momentin kur do të lënë burgun. Rregullorja Evropiane e Burgjeve parashikon se *“regjimi i ofruar për të gjithë të burgosurit përfshin një program të balancuar veprimtarish. Ky regjim u lejon të gjithë*

⁷ [p-standards-inf-2017-5-part-en.docx.pdf](#)

⁸ Një çështje e tillë është gjykuar nga Gjykata e të Drejtave të Njeriut të Këshillit të Evropës në rastin Sulejmanovic kundër Italisë. Gjykata e Strasburgut në vendimin e tyre kanë cilësuar se kufizimi i hapësirës jetike ndaj të dënuarve dhe të paraburgosurve përtej standardeve ligjore të shteteve palë dhe ato të Konventave Ndërkombëtare përbëjnë shkelje të nenit 3 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut.

të burgosurve të kalojnë sa më shumë orë në ditë jashtë qelive të tyre, sipas nevojës për një nivel të përshtatshëm të ndërveprimit njerëzor dhe shoqëror”⁹.

E drejta për të mbajtur kontakte me familjarët dhe miqtë zbatohet përgjithësisht sipas rregullores. Takimet me familjarët kryheshin 4 herë në muaj dhe ndër këto takime dhe një online me skype e cila zgjaste rreth 30 minuta. Aktualisht në institucion ndodhej një kompjuter i cili shërbente për lidhjen e komunikimit me familjarët nëpërmjet skype. Referuar numrit prej 164 të paraburgosurish në institucion 1 kompjuter është i pamjaftueshëm lidhur me këtë shërbim.

Orari i veprimtarive ishte i njëjtë për të gjithë sektorët pavarësisht nga siguria që ata kishin. Nga administrimi i dokumentacionit nga sektori i çështjeve shoqërore konstatuam se aktiviteti që ishte zhvilluar në I.E.V.P. Mine Peza për muajin shkurt ishte:

- ✓ Zhvillimi i temave sociale me të paraburgosur gjatë muajit, si të gjejmë vetë motivimin, nuk ka justifikime, menaxhimi i kohës, disiplina.
- ✓ Implementimi i programeve individuale, të trajtimit për të paraburgosurit që bëjnë pjesë në kategoritë vulnerable.
- ✓ Organizimi dhe monitorimi i aktiviteteve social kulturore. Komuniteti Mysliman, SHKBSH-së dhe Kishës Katolike.

Një mjedis tjetër, që përdorej edhe për këshillime individuale, ndodhej në katin e parë ishte përshtatur në klasë për zhvillimin e procesit arsimor 9-vjeçar për vitin 2024-2025, aktualisht ishin 7 të paraburgosur që zhvillonin mësimin. Kjo klasë ishte e pajisur me tavolinë, karrige etj.

Aktualisht në institucion nuk zhvilloheshin kurse profesionale, duke qenë kjo mungesë thelbësore për procesin e riintegrit të personave.

Avokati i Popullit vëren me keqardhje të thellë se ka patur mungesë në qasjen bashkëpunuese të institucioneve përgjegjëse mbi garantimin e të drejtave të personave të privuar nga liria lidhur me ofrimin e kurseve profesionale në burgje.

Dosjet psiko-sociale ishin të plotësuara mirë, me përmbledhjet nga takimet e fundit me të paraburgosurit, me programet individuale dhe në grup, me vlerësimet e tre mujoreve dhe gjithë dokumentet e tjera mbështetëse.

Shërbimi shëndetësor

Përgjatë inspektimit grupi i punës i kushtoi një vëmendje të veçantë shërbimit shëndetësor duke u udhëhequr nga parimet e CPT gjatë vizitave në shërbimet e kujdesit shëndetësor të burgjeve mund të paraqiten nën titujt e mëposhtëm: a. Aksesit te një mjek b. Barasvlefshmëria e kujdesit c. Miratimi dhe konfidencialiteti i pacientit d.

⁹ Rregullorja e Evropiane e Burgjeve Pika25.1 dhe 25.2; <http://www.coe.int/t/DGHL/STANDARDSETTING/PRISONS/EPR/EPR-Albanian.pdf>

Kujdes shëndetësor parandalues e. Asistencë humanitare f. Pavarësi profesionale g. Kompetencë profesionale.

Gjatë vizitës në I.E.V.P, “Mine Peza” 302 Tiranë si dhe nga intervistat me të paraburgosurit, problematika u konstatuan kryesisht në mungesat e medikamenteve, të cilat shpesh mbuloheshin edhe me kontributet e sjelljes nga familja. Skema e rimbursimit të ilaçeve kishte disa vështirësi për të paraburgosurit, të cilët për shkak të vonesave në plotësimin e dokumentacionit të dosjeve personale e kishin më të vështirë sigurimin e ilaçeve. Të paraburgosurit ishin të pajisur me librezë shëndetësore. Skema e furnizimit me ilaçe për personat me probleme akute funksiononte normalisht në farmacinë e institucionit ku ndodheshin 27 medikamente të urgjencës.

CPT¹⁰ referon që: ***“Derisa qëndrojnë në burg, personave të dënuar duhet tu mundësohet qasja deri te mjeku në çdo kohë, pa marrë parasysh faktin e regjimit të burgosjes së tyre” dhe se “shërbimi shëndetësor duhet të organizohet në atë mënyrë, që do të mundësojë që kërkesat për konsultime mjekësore të ofrohen pa zgjatje të pa nevojshme”.***

Sigurimi i ilaçeve sigurohej nga tre burime dhe konkretisht nga depo farmaceutike, furnizim me blerjet e drejtpërdrejta nga fondi i siguruar nga D.P.B dhe furnizim nga fondi i vetë institucionit.

Personeli i kujdesit mjekësor në I.E.V.P “Mine Peza”, 302 sipas organikës përbëhej nga 1(një) mjek, 1(një) farmacist, 1(një) stomatolog dhe 4 (katër) ndihmës mjekë.

Në I.E.V.P, “Mine Peza” 302 në katin e parë në hyrje të regjimit ndodhej godina një-katëshe më vete, ku ishin të vendosura dhoma e stomatologut, dhoma e vizitave të mjekut, si dhe kishte 1(një) farmaci për institucionin. Dhoma e stomatologut ishte e pajisur me karrige dhe sterilizues, uniti dentar ishte i ri dhe mjeku stomatolog ishte i pranishëm. Dhoma e mjekut dhe farmacia ishin të lyera dhe ishin në gjendje të mirë me kushte të mira higjieno-sanitare. Në I.E.V.P, “Mine Peza” 302 Tiranë u konstatua, sërisht mungonte ambulanca për të shoqëruar personat në spitalet përkatëse të vendit. Është për tu theksuar se Rregullorja Evropiane e Burgjeve shprehet se: ***“Autoritetet e burgut ruajnë shëndetin e të gjithë të burgosurve që janë në kujdesin e tyre. Shërbimet mjekësore në burg organizohen në bashkëpunim të ngushtë me administrimin shëndetësor të komunitetit ose të shtetit. Të burgosurit i ofrohen shërbimet mjekësore, kirurgjike dhe psikiatrike, duke përfshirë dhe ato shërbime që janë të disponueshme në komunitet”.***

Në institucion të paraburgosurit me probleme të shëndetit mendor ishin 13¹¹, 35 persona të sëmurë kronik, 7 persona me diabet dhe 4 persona përdorues të lëndëve narkotike që trajtohen me metadon.

¹⁰ CPT, Komiteti për Parandalimin e Torturës, *Derisa qëndrojnë në burg, personave të dënuar duhet tu mundësohet qasja deri te mjeku në çdo kohë, pa marrë parasysh faktin e regjimit të burgosjes së tyre*

¹¹ Rekomandim i KPT: Në burgun nr. 302, delegacioni vuri re se receta e përgjithshme e diazepinave ishte mjaft e lartë. Në veçanti, u vërejt se, në muajt e fundit, mjeku i burgut shpesh përshkruante diazepam përmes injeksioneve intravenoze. Për më tepër, u duk se një infermiere mundet, pa përshkrimin e mjekut, të

Në raportin për Qeverinë Shqiptare në vizitën periodike në Shqipëri të kryer nga Komiteti Evropian për Parandalimin e Torturës dhe Çnjerëzore ose Trajtim ose Ndëshkim Degradues (CPT) nga data 4 deri më 15 maj 2023 rekomanduar¹²:

KPT rekomandon që të ndërmerren hapa për të organizuar vizita të rregullta (të paktën dy herë në muaj, në të gjitha burgjet e tjera në Shqipëri. Siç është theksuar nga KPT në të kaluarën, prania e rregullt e psikiatrit në burg do të mundësojë që të burgosurit me probleme të shëndetit mendor të identifikohen në kohë dhe iu dha trajtimi i duhur.

Nga informacioni i marrë nga stafi mjekësor rezulton se mjeku psikiatër i Qendrës Spitalore të Burgjeve kryente vizita mjekësore në IEVP 1 herë në dy javë.

Komiteti rekomandon gjithashtu që autoritetet shqiptare të përforcojnë dispozitën e kujdesi psikologjik në burgje, veçanërisht për sa i përket punës klinike terapeutike me të burgosurit. Në këtë kontekst, nevojiten përpjekje për të rekrutuar psikologë klinikë, të cilët duhet të jenë pjesë e tyre ekipi i kujdesit shëndetësor.

Nga këqyrja e dokumentacionit të stafit mjekësor, e në veçanti atij të mjekut, u konstatua se kartelat klinike mbaheshin në dollap në dhomën e mjekut. Gjithashtu u këqyren regjistri i vizitave të mjekut, regjistrat e informacionit 24 orësh të infermierëve, të cilat ishin mbajtur me rregull.

Me gjithë vështirësitë e hasura për arsye të brendshme apo/dhe të jashtme të institucionit u konstatua se konsultat dhe ekzaminimet në qendra të specializuara spitalore ishin realizuar duke i dhënë prioritet rasteve emergjente, duke i dokumentuar edhe në kartelat përkatëse. Ndërkohë që një pjesë, që sapo ishin akomoduar në këtë institucion, prisnin plotësimin e dokumenteve përkatëse për vazhdimin e procedurës së pajisjes me librezë shëndetësore.

Për sa më sipër dhe në mbështetje të pikës 3, të nenit, 63 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku thuhet se: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike”*; të nenit 21, germa “b” të ligjit nr. 8454 dt. 04.02.1999 *“Për Avokatin e Popullit”*, i ndryshuar, ku thuhet se: *“Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive; si dhe në bazë të nenit 81, pika 2/b të ligjit Nr. 81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”*, ku parashikohet midis të tjerash se: *“Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës ka këto kompetenca:*

administrojë ose shpërndajë tek të burgosurit një gamë të gjerë ilaçesh, përfshirë diazepam. KPT dëshiron të marrë komentet e autoriteteve shqiptare për këto çështje.

KPT rekomandon që autoritetet shqiptare të rishikojnë burimet e personelit të kujdesit shëndetësor në të gjitha burgjet që kanë një SKV, në dritën e vërejtjeve të mësipërme.

¹²<https://www.coe.int/sq/web/cpt/-/council-of-europe-anti-torture-committee-cpt-publishes-report-on-albania.-1>

b) paraqet rekomandime për organet përkatëse, me qëllim që të përmirësohen trajtimi dhe kushtet e individëve që u është hequr liria dhe të parandalohet tortura, trajtimi ose dënimi i egër, çnjerëzor ose poshtërues.”.

REKOMANDOJMË:

1. Marrjen e masave për rishikimin e kapaciteteve të I.E.V.P. “Mine Peza” (302) duke respektuar standardet e parashikuara në nenin 33 të ligjit nr. 81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, për hapësirën jetike për çdo të burgosur.
2. Marrjen e masave për rishpërndarjen e menjëhershme e të paraburgosurve duke ju referuar kapaciteteve, për të siguruar së paku 4m² hapësirë jetese për person në qeli (pa përfshirë hapësirën e tualetit).
3. Marrjen e masave për kryerjen e një rikonstruksioni të plotë të I.E.V.P “Mine Peza” si një proces parësor i cili që jo vetëm përmirëson kushtet fizike dhe infrastrukture, por gjithashtu mundëson rehabilitimin, edukimin dhe ndihmën që ata të integrohen më mirë në shoqëri pas përfundimit të dënimit.
4. Marrjen e masave të menjëhershme për uljen e numrit të paraburgosurve në dhomën nr.1 kati i tretë gjithashtu kryerja e dezinfektimit dhe lyerjen e kësaj dhome.
5. Marrjen e masave për të përmirësuar cilësinë dhe larmishmërinë e ushqimit në I.E.V.P. 302 në shërbim të paraburgosurve, duke shmangur shpërdorimin e tij në vijim.
6. Marrjen e masave për pajisjen me sistem ajrimi të ambienteve të përbashkëta të vuajtjes së dënimit, korridoret janë pa dritare dhe ka mungesë ajrimi.
7. Marrjen e masave të menjëhershme për lyerjen dhe dezinfektimin e dhomave të banimit të paraburgosurve.
8. Marrjen e masave për rritjen e numrit të aktiviteteve, me qëllim që të paraburgosurit, të kenë aktivitete të shumta edukative, sportive dhe të mundësohet që të zhvillojnë edhe aktivitete tjera, me të cilat shprehin talentin në punën dhe zanatet e tyre që ata zotërojnë, të informohet Institucioni i Avokatit të Popullit për ndjekjen dhe shpeshitinë e tyre.
9. Marrjen e masave të menjëhershme për të zhvilluar kurse profesionale në favor të personave të paraburgosur në I.E.V.P, “Mine Peza” 302 Tiranë.

10. Marrjen e masave për shtimin e kompjuterëve për të komunikuar me platformën online me familjen, krahasuar me numrin e të paraburgosurve dhe përcaktimin e kohës së përshtatshme.
11. Marrjen e masave për vënien në funksion të plotë të lavanderisë duke shtuar numrin e makinave larëse kjo në proporcion me numrin e përgjithshëm të të paraburgosurve.
12. Marrjen e masave për pajisjen e Institucionit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale (I.E.V.P), “Mine Peza” 302 Tiranë me ambulancë për të shoqëruar personat në spitalet përkatëse të vendit në përputhje me nevojat shëndetësore të të paraburgosurve
13. Të merren masat e menjëhershme për rishikimin e rregullores së brendshme të institucionit për shtimin e normativave mujore për të paraburgosurit me qëllim mbajtjen e higjienës personale, mirëmbajtjen dhe pastërtinë në dhomat e banimit dhe ambientet e përbashkëta, si dhe shmangien e abuzimeve nga punonjësit e institucionit në shpërndarjen e tyre.
14. Marrjen e masave për pajisjen e dhomave të paraburgosurve me dollapë për të mbajtur sendet personale dhe ushqimet.

Për qëndrimin dhe masat që do të merrni në zbatim të këtij rekomandimi, të vihem në dijeni brenda afatit 30 ditë sipas nenit 22 të Ligjit Nr. 8454 dt. 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj.

**KOMISIONERI
i Mekanizmit Kombëtar
për Parandalimin e Torturës
(MKPT)
Ahmet PRENÇI**

DV

